




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT



ZYRA PËRMBARIMORE
"GAZMOR B GURI"

Nr. 214 Regj, Nr. 416 Prot

Tiranë, më 04.03.2019

URDHËR

"PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"

Drejtuar : QENDRES KOMBETARE TE BIZNESIT (QKB) TIRANE

Per dijeni: Debitorit, Shoqeria "MERGA " Shpk me NIPT: K26513469M me Administrator Z. Ilir Gaçi
Perfaqesuar nga Av. Elvis Turtulli, caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane me Vendimin
Nr.10209 , date 11.12.2018.

Adresa : Rruga "Rreshit Çollaku" Hotel Europa, Prane Gjykates se Larte, Tirane

Për dijeni: Kreditorit Flutura Tafe Dema , e dtl.15.08.1985 lindur ne Milot ,

Adresa : Rruga e Thesarit 1040 Linzë, Muhamet Deliu 77 2 30, kompleksi ""Merga" Shpk , Tirane

Unë Gazmor Guri ,me detyrë Përmbarues Gjyqësor Privat, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr. 214 Regj, date 12.10.2018 bazuar në Urdherin e Ekzekutimit, Vendimi Nr.2796/U, date 16.03.2018,leshuar per "Titullin Ekzekutiv" Vendimi Nr.2796, date 16.03.2018 , te Gjykates Rrethit Gjyqësor Tirane.

KONSTATOVA:

Se, në date 12.10.2018 është regjistruar pranë zyrës përmbarimore kërkesa e kreditorit, Flutura Tafe Dema, së bashku me Urdherin Ekzekutiv, Vendimi Nr.2796/U, date 16.03.2018,leshuar per "Titullin Ekzekutiv" Vendimi Nr.2796, date 16.03.2018 , te Gjykates Rrethit Gjyqësor Tirane, me objekt e palë:

Kreditor : Flutura Tafe Dema

Debitor : Shoqeria "MERGA " Shpk me NIPT: K26513469M me Administrator Z. Ilir Gaçi

Me objekt: Kthim shume

Me vendim te permbaruesit gjyqësor mbeshtetur në nenin 519 të K.Pr.Civile është kaluar në ekzekutim të menjehershëm te titullit ekzekutiv, rrjedhimisht për ekzekutimin e tij, duhet të kryhet vendosja e masës së sekuestros konservative mbi kredite e debitorit, Shoqeria "MERGA " Shpk me NIPT: K26513469M me Administrator Z. Ilir Gaçi.

Per kete arsye :

Në bazë të neneve 519,527 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe ligjit Nr.10031 ,date11.12.2008, "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat"

URDHËROI:

1.Vendosjen e masës së sekuestros konservative, ne aktivet e pales debitore, Shoqeria "MERGA " Shpk me NIPT: K26513469M me Administrator Z. Ilir Gaçi.

2. Aktivet e mesiperme do te qendrojne te sekuestruara deri ne nje urdherese te dyte nga ana e jone.

3.Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet te na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

4. Per personat që bëhen pengesë ne zbatimin e ketij urdheri do të merren te gjitha masat e parashikuara ne neni 598 e në vijim te K.Pr.Civile, si dhe ne rast se ka vend do te kerkohet ndjekje penale ne baze te dispozitave te Kodit Penal.

5.Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat ne baze te nenit 610 te K.Pr.Civile kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

PERMBARUESI GJYQËSOR
Gazmor GURI

Adresa :Njësia Administrative Nr.9.Rruga:"Hysen Haxhi Dalliu",përballë Prokurorisë Rrethit Gjyqësor, Tiranë, kati I-rë,
NIPT/NUIS: L42104024T Cel .066 2222188, e-mail:gazi.guri@yahoo.com